

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 788 Prot.

Tiranë, më 26.11 2015

**VENDIM Nr. 123, datë 18.11.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.14, të datës 18.11.2015, pasi shqyrtoi **Relacionin e mbikëqyrjes arkeologjike të sondazheve** të realizuara nga Znj. Lida Miraj, individ i licencuar në arkeologji, në kuadër të projektit "**Linja 110 KV, Llapaj-Peshkopi**"-OST Sh.A., paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë **Relacionin e mbikëqyrjes arkeologjike të sondazheve** të realizuara nga Znj. Lida Miraj, individ i licencuar në arkeologji, në kuadër të projektit "**Linja 110 KV, Llapaj-Peshkopi**"-OST Sh.A., paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
- II. Të kryhet nga një subjekt i licencuar në fushën e arkeologjisë, gërmimi arkeologjik i shpëtimit në zonën ku pozicionohet shtylla Nr. 22 (sondazhi Nr. 8), duke lidhur më parë kontratë trepalëshe ndërmjet investitorit, subjektit të licencuar në arkeologji dhe ASHA. Raporti i tij të paraqitet në KKA e radhës.
- III. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja arkeologjike nga DRKK Shkodër, e cila duhet të depozitojë pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dokumentacionin për të, duke lidhur më parë aktmarrëveshje tre palëshe me ASHA dhe investitorin, sipas vendimit të KKA Nr. 102, datë 1.09.2015.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUBINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)